



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

VENDIM

NR. 68, DATË 21.08.2020

PËR  
MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE TË NDODHURA NË STRUKTURËN E  
PRONËSISË SË SHOQËRISË “TEMA TV” SH.P.K.,  
LICENCUAR PËR TRANSMETIME AUDIOVIZIVE

Autoriteti i Mediave Audiovizive, i përbërë nga:

Gentian	Sala	Kryetar
Sami	Nezaj	Zëvendëskryetar
Agron	Gjekmarkaj	Anëtar
Gledis	Gjipali	Anëtar
Suela	Musta	Anëtar

mori në shqyrtim çështjen që i përket palëve:

Kërkues: Shoqëria “TEMA TV” sh.p.k.

Objekt: Mbi ndryshimet e ndodhura në strukturën e pronësisë së shoqërisë “TEMA TV” sh.p.k., licencuar për transmetime audiovizive.

Baza Ligjore: Neni 19, pika 16 të ligjit nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

VËREN SE:

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit (sot Autoriteti i Mediave Audiovizive), ka licencuar shoqërinë “Alsat 1” sh.p.k., me vendimin nr. 113, datë 30.09.2002, për subjektin audio “Radio Alsat”. Me vendimin nr. 122, datë 30.09.2019, AMA ka miratuar ndryshime në strukturën e pronësisë së subjektit dhe ndryshimit e emërimit nga “Radio Alsat” në “MCN Radio”, me zonë ofrimi shërbimi “Qarqet Tiranë dhe Durrës”, me afat vlefshmërie deri në datën 07.11.2022

Me vendimin nr. 95, datë 19.05.2016, AMA ka autorizuar shoqërinë “Tema Tv” sh.p.k., për ofrimin e shërbimit të programit audioviziv mbështetur në internet, me afat vlefshmërie deri në datën 19.05.2021.

Me vendimin nr. 46, datë 25.06.2020, AMA ka pajisur shoqërinë “Tema Tv” sh.p.k., me NIPT: L42404004Q dhe administratorë: z. Endri Meksi dhe zj. Marsida Karabollaj, me licencë për ofrimin e shërbimit të programit audioviziv të përgjithshëm “TVT” në allotmentet Fier, Berat dhe Korçë, për një periudhë prej 8 vjetësh.

Me shkresën e datës 26 qershor 2020, administruar pranë AMA-s, me nr. 1279 prot., datë 26.06.2020, subjekti ka njoftuar për ndryshimet e ndodhura në strukturën e pronësisë së shoqërisë “Tema Tv” sh.p.k., licencuar për transmetime audiovizive. Konkretisht, ortaku i shoqërisë, z. Mero Baze me 20% të kuotave ka dhuruar kuotat që zotëron në këtë shoqëri tek ortaku tjetër, shoqëria “OTIG” sh.p.k., (80% të kuotave) duke e shndërruar në ortak të vetëm, shoqërinë “OTIG” sh.p.k., me 100% të kuotave.

Page | 2

Bashkëlidhur njoftimit, subjekti ka depozituar:

- Ekstraktin Historik të Regjistrimit Tregtar për të dhënat e subjektit, të lëshuar nga QKB-ja, në datën 28.05.2020, nga shqyrtimi i të cilit rezulton se në datën 27.05.2020, kanë ndodhur ndryshimet e mëposhtme: Është larguar ortaku z. Mero Baze, i cili zotëronte 20% të aksioneve duke ja kaluar ortakut ekzistues “OTIG” sh.p.k., (80% të kuotave), i cili shndërrohet ortak i vetëm me 100% të kuotave.

AMA, me shkresën nr. 1729/1 prot., datë 06.07.2020, kërkoi nga subjekti, shoqëria “Tema Tv” sh.p.k. depozitim të kontratës së dhurimit të kuotave, në formën e kërkuar ligjore, origjinal ose kopje e njehsuar me origjinalin.

Në vijim të kërkesës së mësipërme, subjekti me shkresën administruar në AMA me nr. 1729/2 prot., datë 30.07.2020, ka depozituar:

- Kontratë dhurimi, kopje e noterizuar me nr. 5583 rep., të datës 21.05.2020, ndërmjet dhuruesit z. Mero Baze dhe shoqërisë “OTIG” sh.p.k., në cilësinë e pranuesit, të lidhur në datë 21.05.2020, me objekt dhurimin e kuotave që zotëron z. Mero Baze në shoqërinë “Tema Tv” sh.p.k.

Në rastin konkret rezulton se, shoqëria “Tema Tv” sh.p.k., nuk ka hyrë në marrëdhënie juridike civile, objekt i të cilave të jetë veprimtaria radiotelevizive e licencuar, por ortaku i shoqërisë Mero Baze, kuotat që dispononte në këtë shoqëri, ia ka dhuruar ortakut tjetër të subjektit, shoqërisë “OTIG” sh.p.k., që shndërrohet në ortakun e vetëm me 100% të kuotave..

Në mbështetje të parashikimeve të ligjit nr. 97/2013, i ndryshuar, subjektet kanë detyrimin ligjor të njoftojnë për ndryshimet e ndodhura në të dhënat e paraqitura në kërkesën për licencë/autorizim, brenda afatit prej 30 ditësh nga data e kryerjes së ndryshimeve. AMA konstaton se ndryshimet e subjektit janë njoftuar brenda afatit 30 ditor të përcaktuar në nenin 133, pika 2/d, të ligjit nr. 97/2013, i ndryshuar.

Shoqëria “TEMA TV” sh.p.k., ka kryer pagesën në masën 50,000 lekë për ndryshimin e të dhënave në strukturën e pronësisë në datën 13.07.2020, në zbatim të vendimit të AMA-s, për përcaktimin e pagesave për licencë/autorizim.

Sa më sipër, AMA e gjen të drejtë e të mbështetur kërkesën e shoqërisë “TEMA TV” sh.p.k., për miratimin e ndryshimeve të ndodhura në strukturën e pronësisë së subjektit,

**PËR KËTO ARSYE,**

Autoriteti i Mediave Audiovizive, në mbështetje të nenit 19, pika 16, të ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar,

**V E N D O S I:**

Page | 3

1. Miratimin e ndryshimeve të ndodhura në strukturën e pronësisë së shoqërisë "TEMA TV" sh.p.k., licencuar për transmetime audiovizive me ortak të vetëm, shoqërinë "OTIG" sh.p.k., 100% të kuotave.
2. Ngarkohet administrata e AMA-s për kryerjen e veprimeve të mëtejshme në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Kryetar:**

**Gentian**

**SALA**

**Zëvendëskryetar:**

**Sami**

**NEZAJ**

**Anëtarë:**

**Agron**

**GJEKMARKAJ**

**Gledis**

**GJIPALI**

**Suela**

**MUSTA**

